



Datë: 22.08.2025
Numër Protokolli: 6099/2025

A.nr.1097/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj–Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1097/2025 të datës 09.06.2025 të parashtruar nga ankuesi S.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.1097/2025, e datës 09.06.2025, e parashtruar nga ankuesi S.K.
- II. Anulohet** Konkursi me numër reference RN00017245, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve*” në Gjakovë, i shpallur me datë 20.03.2025 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. Obligohet** Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e e Financave, Punës dhe Transfereve që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi S.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 09.06.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3869/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017245, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve*” në Gjakovë, i shpallur me datë 20.03.2025 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 26.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.07.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me Vendim me numër protokolli 3000/2025, të datës 23.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1097/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3869/2025 të datës 09.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Dokument identifikimi; E-mailin e datës 06.05.2025; E-mailin e datës 21.05.2025; Konkursin me numër reference RN00017245 të datës 20.03.2025; Njoftimin e datës 05.05.2025; Njoftimin e datës 07.05.2025; Njoftimin e datës 13.05.2025; E-mailin e datës 21.05.2025; E-mailin e datës 29.05.2025; Listën përfundimtare të datës 30.05.2025; E-mailin e datës 30.05.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 04.07.2025; E-mailin e datës 29.05.2025; E-mailin e datës 20.05.2025; E-mailin e datës 29.05.2025; Renditjen përfundimtare të datës 30.05.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 30.05.2025; Testin me shkrim të datës 27.05.2025; Njoftimin e datës 30.05.2025; Vendimin me Nr.154/2025 të datës 02.05.2025; Akt emërimit me numër protokolli 2458/2024 të datës 25.09.2024; Akt emërimit me numër protokolli 2368/2024 të datës 17.09.2024; Akt emërimit me numër protokolli 1057/2024 të datës 04.05.2024; Akt emërimit me numër protokolli 1208/2024 të datës 11.05.2024; Akt emërimit me numër protokolli 935/2024 të datës 04.05.2024; E-mailin e datës 19.03.2025; Listën kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Aplikacionin e ankuesit të datës 21.03.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidati D.N të datës 14.04.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur përkatës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 20.03.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00017245, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve" në Gjakovë, me afat aplikimi nga data 21.03.2025 deri me datë 19.04.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë dhjetë (10) kandidatë, ku prej fillimisht sipas njoftimit të datës 05.05.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, vetëm dy (2) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, në mesin e tyre edhe ankuesi.

Mirëpo, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me datë 07.05.2025 ka publikuar Njoftimin për kthimin e procedurës në fazën e verifikimit paraprak, ashtu që me datë 13.05.2025 ka nxjerrë Njoftimin, nga i cili tani më rezultojnë pesë (5) kandidatë të cilët kanë plotësuar kriteret dhe janë përfshirë në listën e ngushtë, duke përfshirë këtu edhe ankuesin i cili i është nënshtruar testimit me shkrim në të cilin ka arritur t'i mbledh 45.4 pikë, nga rrjedh se i njëjti nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit atë të intervistës me gojë.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 30.05.2025 ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati D.N, me gjithsejtë 88 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi. është shpallur kandidat fitues për pozitën *Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve* në Gjakovë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procedura përkatëse është zhvilluar përmes shkeljeve ligjore, duke theksuar ndër të tjera se organi i punësimit me rastin e publikimit të njoftimit të datës 07.05.2025 për kthimin e procedurës së rekrutimit në fazën e verifikimit paraprak, dhe më pas publikimit të njoftimit të datës 13.05.2025, mbi ndryshimin e listës së verifikimit paraprak, ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, si dhe po ashtu i njëjti thekson se tek vlerësimi i esesë është nënvlerësuar qëllimisht nën pragun e 50 pikëve, për arsye se ka 20 vite përvojë pune dhe në intervistë do të vlerësohej CV-ja. Andaj i njëjti kërkon aprovimin e ankesës dhe kthimin e procedurës së rekrutimit në pikën zero, ashtu që vetëm i njëjti dhe kandidatja V.S, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret sipas njoftimit 05.05.2025 të vazhdojnë tutje në procedurat e rekrutimit për pozitën përkatëse.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017245, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese *Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve* në Gjakovë dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Shkenca Shoqërore; Kërkesat Specifike:* *Nuk ka; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale*, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale të sapo theksuara janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/3 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën e Drejtues i Ulët.

Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të procedurës përkatëse të rekrutimit, duke u mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*, ka analizuar dosjen e kandidatit fitues, ndaj me këtë rast Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”*, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të*

dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Ndërsa, sipas nën pikës 3 dhe 5 të pikës 5 të konkursit të datës 27.01.2025, rezulton se gjithë kandidatët kanë qenë të njoftuar lidhur me dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit, ku është përcaktuar se: *-Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen dhe angazhimin në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jaashhtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organit kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës. - Kopjet e dokumenteve tjetra që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, bazuar dispozitat e lartë theksuara ligjore, kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës dhe dokumentet e kërkuara mbi dëshmimin e përvojës së punës të pasqyruara si më sipër, ka analizuar aplikacionin e kandidatit fitues D.N, të datës 14.04.2025, nga i cili rezulton se i njëjti si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.1433/15 të datës 08.10.2015 të lëshuar nga Kolegji AAB, me anë të cilit dokument dëshmohet se i njëjti më datë 29.06.2015 ka mbaruar studimet themelore universitare në Programin Menaxhment dhe Informatikë dhe ka fituar titullin Bachelor, rrjedhimisht me këtë rast i njëjti dëshmon se ka plotësuar kriterin arsimor të përcaktuar me konkursin e lartë cekur, ndërsa po ashtu ka bashkangjitur edhe Diplomën me numër 2299/20 të datës 24.11.2020 të lëshuar nga Kolegji AAB, përmes së cilës dëshmohet se kandidati në fjalë, më datë 18.11.2020 ka fituar titullin Master i Arteve në Menaxhment dhe Informatikë.

Ndërsa, sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës tre (3) vjeçare të punës profesionale, kandidati në fjalë ka bashkangjitur vetëm Vërtetimin me Nr.KEDS-HR-G-RR-33 të datës 10.04.2025, përmes së cilit theksohet se i njëjti nga viti 2013 është i angazhuar në marrëdhënie pune tek punëdhënësi i sektorit privat KEDS Sh. A, andaj duke qenë se kjo përvojë pune e kandidatit në fjalë nuk hynë në kuadër të institucioneve publike, i njëjti me këtë rast duhej të njëjtën ta mbështeste edhe me pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo me pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale, ashtu siç është kërkuar edhe me shpalljen e konkursit përkatës, si rrjedhojë e kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidati fitues me anë të dëshmimeve të bashkangjitura nuk ka vërtetuar se plotëson kriterin prej tri (3) viteve përvojë pune profesionale.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se kandidati fitues D.N me dëshmitë e bashkangjitura me rastin e aplikimit në konkursin përkatës nuk ka vërtetuar se plotëson kërkesat e përgjithshme formale, gjegjësisht kriterin e përvojës së punës, dhe se në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si njësi përgjegjëse në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit, rrjedhimisht me rastin përfshirjes në listën e ngushtë kandidatin përkatës, dhe atë sipas Njoftimit të datës 13.05.2025, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike si dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës së kategorisë së ulët drejtuese "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve" në Gjakovë, ka përfshirë në listë të ngushtë kandidatë që nuk

plotësojnë kriteret dhe se i njëjti është shpallur kandidatë fitues, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 44 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese; dhe si rrjedhojë e kësaj ka bërë që procedura e rekrutimit, të zhvillohet në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017245, për pozitën e punës “Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve” në Gjakovë, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1097/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.K;
- Sektorit të Burimeve Njerëzore në të Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.